

VENDIM
Nr.593, datë 31.8.2006

PËR TRANSFERIMIN E TEATRIT KOMBËTAR DHE TË GALERISË KOMBËTARE TË ARTEVE NË MJEDISËT E QENDRËS NDËRKOMBËTARE TË KULTURËS “PJETËR ARBNORI”

Në mbështetje të nenit të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 10 e 15, shkronja “c” të ligjit nr.8743, datë 22.2.2001 “Për pronat e paluajtshme, të shtetit”, me propozimin e Ministrit të Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Transferimin e Teatrit Kombëtar dhe të Galerisë Kombëtare të Arteve në Qendrën Ndërkombëtare të Kulturës “Pjetër Arbërori”.

2. Brenda 3 muajve nga hyrja në fuqi e këtij vendimi, Ministria e Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve të bëjë lirim të mjediseve dhe sipërfaqeve funksionale të Qendrës Ndërkombëtare të Kulturës nga aktivitetet private e të përgatisë rikonstrukcionin e qendrës në funksion të destinacionit të ri publik.

3. Ngarkohet Ministri i Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha